



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA IV

**Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 91.
Prishtinë, më 18.03.2014 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-01**

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Živković, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Hatim Baxhaku, Saša Milosavljević, Jelena Bontic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Mungoi: Glauk Konjufca dhe Petar Miletić.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuese e OSB-së, Lejla Selimi, përfaqësuesi i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Živković** –kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së mbajtur më 27.02.2014 dhe 5.03.2014
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore, me amandamente të komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-253 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë, me amandamente të komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja– konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 27.02.2014 dhe 5.03.2014;

Kryesuesja - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjeve të mbajtura më 27.02.2014 dhe 5.03.2014, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore, me amendamente të komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;

Kryesuesja- paraqet për shqyrtim Projektligjin nr. 04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore me Raport amendamente të Komisionit Funkcional dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në përfundim i cili do t'i dërgohet Komisionit Funkcional.

Me që nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-247 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat Ekziston e Drejta Banesore dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-253 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë, me amendamente të komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr. 04/L-253 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë me Raport amendamente amendamente të Komisionit Funkcional dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

P ë r f u n d i m

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-253 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme

Kryesuesja – i njoftoi anëtarët e komisionit se kemi paqartësi në amendament e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në Projektligjin nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti. Në kuadër të procedurave Parlamentare, në afat prej dy jave Projektligji do të kalojë në lexim të dytë në Kuvend. Për arsye të respektimit të afateve kohore, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Obligohet administrata për mbështetje të komisionit që në takim të komision, me datën 25.03.2014 të ftohet kryetari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, Fikrim Damka dhe Ministri i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Nenad Rašić, për të dhënë sqarime në propozim amendamentet e komisionit funksional.

Rasim Demiri – e informoi komisionin lidhur me vendimin për rrëzimit objekteve ilegale (shtëpi private) siç është rasti në zonën e Prevalës, fshati Gorn. Ai propozoi që shtëpitë e këtyre fshatarëve të legalizohen, pasi janë ndërtuar në pronën e tyre. Pas konsultimeve të anëtarëve të komisioni, lidhur me këtë vendim, komisioni murr këtë:

Përfundim

Obligohet anëtari e komisionit Rasim Demiri, që në mbledhjen e radhës, të sjell dokumentet zyrtare në komision, me qëllim të shqyrtimit të kësaj çështje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Jasmina Živković